

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE PER SHERBIMET QE DO TE KRYHEN PER MIRMBAJTJEN DHE PASTRIMIN E RRUGEVE RURALE NGA DEBORA NE TE 4 NJESITE ADMINISTRATIVE TE BASHKISE DEVOLL**

Ne baze te ligjit 139 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen Vendore” dhe VKM nr.915 date 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve te bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve” Bashkia Devoll eshte autoriteti pergjegjes per administrimin dhe mirembajtjen e infrastruktures se rrjetit rrugor rural, ku perfshihen segmentet rrugore pjese e nenndarjeve ne administrim të saj. Per shkak te pozicionit gjeografik ,kushteve te veshtira klimaterike dhe ekspozimit te vazhdueshem ndaj rreshjeve te bores gjate stines se dimrit eshte e nevojshme mirmbajtja e rugeve rurale ,per te parandaluar bllokimin dhe mundesuar qarkullimin e lire dhe te sigurt ne te gjithë segmentet rurale ne territorin e Bashkise Devoll . Ne te gjithë territorin e Bashkise Devoll rezultojne gjithsej 28 segmente rrugore rrurale me nje gjatesi totale prej 99.8 km ,nga te cilat 4 segment rrugore nuk jane te shtruara me asfalt reth (19.3 km) . Operatoret ekonomik duhet qe te plotesojne kapacitetet ligjore, teknike dhe profesionale per kryerjen e ketij prokurimi. Sherbimet e mirembajtjes do te realizohen konform kushteve teknike te zbatimit ne fuqi si dhe kerkesave specifike te investitorit sipas zerave te veçante:

### ***A. Pastrimi i kanaleve anesore te kullimit:***

Ne kete kategori perfshihen punimet qe do te behen ne seksionin e kanalit.

- Te sigurohet largimi i dherave apo mbeturinave ne menyre qe ato te mos kene mundesi te rikthehen ne kanal si dhe nderhyrja te tjera si germime apo sistemim te kanaleve egzistuese per te mundesuar qarkullimin/kullimin e ujit dhe per te shmangur daljen e tij ne karenxhate apo gryerjen e rrugeve me cakull si dhe demtimin e tokave bujqesore pereth .
- Keto punime do te kryhen me mjete germimi .

### ***B. Pastrimi dhe lirimi i Tombinove rrethore dhe katrore***

#### **Pershkrim**

Ky ze do mbuloje pastrimin dhe lirimin e depozitave dhe plehrave te tjera nga tombinot rrethore dhe katrore si dhe hyrjet dhe daljet. Do te behet pastrimi i materialeve te teperta duke i ngarkuar dhe transportuar jashte rruges.

#### **Kerkesa**

Tombinot rrethore do pastrohen aq sa te lejojne kullim efektiv te ujit nepermjet trupit te rruges. Te pakten  $\frac{3}{4}$  e diametrit te tubit do te jete i lire nga depozitimet duke lejuar rrjedhjen e lire te ujit.

<b>Niveli fillestar:</b>	Depozitat qe kalojne 15% te diametrit te tombinos. Tombino eshte ne gjendje pune.
<b>Niveli minimal:</b>	Me shume se 1/4 e diametrit te cilindrit eshte e mbushur me depozita. Funkcioni i tombinos eshte i pakesuar.

Tombinot do te pastrohen aq sa te lejojne kullimin efektiv te ujit nepermjet trupit te rruges.

### **C. Punime mirembajtje ne rruge rurale me dhe pa asfalt .**

**a.Mbushje, rrafshim e ngjeshje te rrugeve :** Ne kete kategori perfshihen punimet qe kane te bejne me evadimin e materialeve te teperta nga trupi i rruges.

- Do te behet rrafshimi, mbushja dhe ngjeshja ne trupin e rruges duke ruajtur parametrat e saj si pjerresia, gjeresia etj(ne segmentet e pa asfaltuara).
- Duhet te behet largimi me kujdes i materialeve te rreshqitura ne nje vend te sigurte ne menyre qe ato te mos rifuten ne kanale apo ne trupin e rruges.(rruget me dhe pa asfalt)

**b. Mbushje gropash me çakull:** Ne kete kategori perfshihen punimet qe kane te bejne me mbushjen e gropave te krijuara ne trupin e rruges me çakull,(ne segmentet e pa asfaltuara)

- Perparesi duhet t'i jepet gropave me sipërfaqe me te madhe se 0.3 m ose me thellesi me te madhe se 0.1 m.
- Do te perdoret material mbushes i njejte me ate te rruges per te mbushur gropat me shtresa jo me te medha se 10 cm (materiali duhet te ngjishet)
- Pas mbushjes duhet te kryje proceset e ngjeshjes (rul vibrues)

**c. Pastrim i mbeturinave/inerte nga tombinot:** Ne kete kategori perfshihen punimet qe kane te bejne me evadimin e materialeve te teperta.

- Do te behet pastrimi i dherave ose mbetjeve brenda dhe dhe jashte daljes se tombinove.
- Do te behet largimi i inerteve larg tombinove ne menyre qe te parandalohet bllokimi i tyre ne te ardhmen.

### **- MIRËMBAJTJA DIMËRORE**

**I.**Moti në dimer shpesh here është i paparashikueshëm, me intensitet të ndryshueshëm gjatë periudhave pak a shumë të gjata kohore, dhe kërkon një qasje fleksibile në sigurimin e shërbimeve. Kushtet për udhëtimin e automjeteve dhe siguria në rrugë gjatë dimrit janë mjaft të kufizuara nga bora dhe akulli. Të gjitha masat e ndërmarra për të kundërvepruar ndaj pasojave të akullit dhe dëborës mund të përshkruhen si Shërbime për Mirëmbajtjen Dimërore. Para se gjithash ato përfshijnë:

- Masat paraprake ( tabelat e bores ,te cilat do te vendosen ne te gjitha rruget me dhe pa sfalt ku eshte e nevojshme per sinjalizimin dhe orientimin e drejtuesve te mjeteve,perparesi kane segmentet e veshtira per tu kaluar ,me kthesa dhe qe jane burim aksidentesh .
- Pastrimin e borës
- Shmangia e ngricave
- Masat kunder akullit
- Largimin e gurëve të rënë dhe mbeturinave nga rruga
- Sigurimi i kripës ose materialeve alternativ

Pastrimi i borës përfshin detyrat për shkrifetimin dhe transportin e borës se hequr. Ndryshe nga

uji, bora mund të ngjeshet por nuk është elastike. Kur bora ngjeshet ajo e ruan formën e vet. **Për ketë arsye është tëpër e rendësishme largimi i saj në kohë.** Shërbimit e Mirëmbajtjes Dimërore janë në të mirë të sigurise në rrugë dhe, si rrjedhoje janë shumë të rendësishme për qarkullimin dhe levizjen e mjeteve dhe njerezve.

### **1. Përparësitë e Shërbimeve**

Për trajtimin e sipërfaqës së rrugës në përgjithësi, do të përdorët kripa mbi të gjitha rrugët, ndërsa guriçka apo rere do të shpërndahet në rrugët me zhavorr/cakull. Duhet pasur kujdes që të përdorët sasia minimale e materialit të nevojshem për t'i kapërcyer kushtet e këqija.

### **2. Rrugët me çakull**

Këto rrugë duhet të pastrohen nga bora ose akulli, ditë e natë, në tërë gjatësinë e tyre. Seksioni rrugor duhet të pastrohet së pari në një gjëresi prej 3.0 – 3.5 m. Gjëresia shtese për të lejuar parakalimin duhet të pastrohet çdo 300 deri në 500 m, d.m.th. në distanca të shkurtëra të mjaftueshme për të lejuar drejtuesit e automjeteve të shikojnë gjëresinë ekstra.

Brenda dy ditëve nga operacioni i parë i pastrimit, duhet të pastrohet një kalim shtese në një gjëresi së paku 5 metra, duke siguruar gjithashtu që sipërfaqja e zgjëruar e pastruar të ketë të njëjtin nivel.

## **II. Materialet Kunder Ngrices**

Materialet më poshtë janë të vlefshme për t'iu kundërvënë kushtëve të ngricave:

- a. Materiale të ashpra
- b. Materiale për shkrirjen e akullit.
- c. Kimikate antifreeze

Me Materialet e ashpra, ngricat mund të zvogëlohen por jo të menjahohen plotësisht. Materialet për shkrirjen e akullit mund t'i zbusin dhe t'i menjanojnë ngricat. Shpërndarja e Materialit të ashpër mund të aplikohet për të rritur në mënyrë mekanike ferkimin (ashpërsinë) në sipërfaqën qarkulluese të rrugës së ngricë; Materialet për shkrirjen e akullit kanë efektë fizike.

### **1. Materialet e ashpra:**

Materialet e mëposhtme mund të përdoren për ta zbutur akullin në sipërfaqën qarkulluese:

- Gure të thyer ose fraksionë me përmasa deri në 5 mm për rrugët normale. Për rrugët malorë me shtrese të trashë të borës rekomandohen fraksionë me të medha. Rruga e ngrirë duhet trajtuar me guricka të imta.

Për ta arritur efektin e zbutjes nevojitet një vëllim prej **150 g/m<sup>2</sup>**. Efekti i shpërndarjes së materialeve të ashpra varet nga përberja granulare, formacioni, sipërfaqja dhe qëndrueshmëria e minëraleve. Sa më i madh të jetë vëllimi i gurëve të thyer (sa më shumë skaje) aq më mirë do të jetë.

### **2. Materialet për shkrirjen e akullit dhe efekti i tyre:**

Kripa mundet vetëm ta shkrijë akullin nëse krijohet një tretje e kripës dhe e ujit. Ky solucion krijohet kur kripa vjen në kontakt me akullin ose borën dhe kur kripa ta thithe lagështinë. Në varesi të ngopjes, solucionin nuk do të ngrije deri në temperaturat të caktuara nën zero. Proçesi i shkrirjes vonohet nga zvogelimi i përqëndrimit të kripës dhe nga renia e temperaturave. Temperaturat në kufirin e efikasitetit dhe lagështia e zvogëluar, ndikojnë në shtyrjen e fillimit të proçesit të shkrirjes.

Megjithatë, proçesi i shkrirjes mund të vonohet nëse kokërrzat janë tepër të ashpra ose, nëse gjatë shpërndarjes, kokërrzat hidhen jashtë sipërfaqës qarkulluese të rrugës.

Kripa e gurit ose kripa për shkrirje nuk do duhet të përmbajnë me shumë se 5% të thërmijave me përmasa nën 0.16 mm e as copëza me të mëdha se 5 mm.

Kripa për shkrirje nuk duhet të përmbajë elementë të qëndrueshme ndaj ujit e as përbërës të tjerë që do ta ngadalësonin proçesin e shkrirjes.

Meqënëse faktorët ndikues janë shumë kompleks dhe në varesi të njeri tjetrit, nuk është e mundur që të jepen sasi fikse të materialeve për shpërndarje në rastetë veçanta. Mund të jepen vetëm intervale në të cilat mund të luhatët vëllimi i shpërndarjes për kushtë atmosferike të veçanta dhe në raste të ngricave.

***Duhet respektuar këto sasi të shpërndarjes:***

**Tabela 2:** Sasitë e shpërndarjes

Shpërndarja parandaluese në rrugë të thatë/ të lagësht	5 deri 15 g/m <sup>2</sup>
Shpërndarja parandaluese në rrugë të lagët/para shiut me ngrica	10 deri 30 g/m <sup>2</sup>
Shpërndarja për ngricë të lehtë dhe akull	5 deri 20 g/m <sup>2</sup>
Shpërndarja për akull të zi/ pas shiut me ngricë	15 deri 40 g/m <sup>2</sup>
Shpërndarja për borë/ borë të ngrirë	15 deri 40 g/m <sup>2</sup>

Vlerat me të mëdha janë të domosdoshme në veçanti për Temperaturat të ulëta (përafërsisht -15 C°), ndërsa vlerat me të ulëta për ngrica të lehta dhe për Temperaturat fill pas pikës së ngrirjes.

### **III. Pajisjet për Mirëmbajtjen Dimërore:**

#### **1. Automjetet për Shpërndarje**

Për shpërndarjen e materialeve të sipër përmendura duhen përdorur kamionë me kapacitet bartës minimumi 6 (gjashtë) tonë. Kamionët nuk duhet të mbingarkohen dhe duhet t'u bëhet servis i rregullt, për të qënë në gjëndje të mirë shërbimi.

#### **2. Pajisjet për Pastrim - Borëpastrueset (plugjët e dëborës)**

Për ta pastruar borën, duhen përdorur plugjët efikase të borës. Duhet të përdoren borëpastruese (plugjët) çeliku të cilat montohen me lehtësi në pjesën e përparme të kamionit. Borëpastrueset duhet të ngrihen e të ulen në menyrë pneumatike ose hidraulike.

Gjërësia e borëpastrueses (plugut të borës) duhet të jetë se paku 0.40 m me e mëdhe se gjërësia e

automjetit. Keshtu që gjërësia e borëpastrueses (plugut të borës) është 2.90 m për pjesen kaluese të rrugës. Për shtigjet e këmbësorëve duhen përdorur plugje me të ngushta.

Plugjet me tehe të lakuara ose këndore e ngrejné borën nga niveli i tokës. Gjatë levizjes së borëpastrueses përpara, shtresa e dëborës ngritet lartë nga tehu dhe grumbullohet anash rrugës. Kjo krijon mure anësorë të cilët duhen hequr posaçërisht në vendet ku pritet rrëzimi i tyre ose në pjese të ngushta të rrugës.

Kapaciteti i motorrit të automjeteve që shërben për montim të plugjeve të borës duhet t'i përshtatet kushteve të përgjithshme të borës si dhe vendit.

### ***Mund të përdorën dy lloje të plugjeve të borës:***

- a. Plugu me një anë – që e pastron borën në një anë
- b. Plugu me dy tëha – që e pastron borën në të dyja anët.

### **3. Pastrimi i dëborës**

Një shtrese deborë mund të përmbajë borë me fortësi të ndryshme. Përpjekja që duhet bërë për të shkrire borën rritet sa më e ngjeshur që të jetë ajo. Kripërat shkrirese të shpërndara në deborën e rënë largojné aftësinë e dëborës për tu ngjeshur në sipërfaqet e rrugës dhe formimin në këtë mënyrë të shtresave të forta.

Energjia fiziko-kimike e zbatuar gjatë kripezimit e ul vëllimin e punës mekanike për ta pastruar dëborën. Kjo rezulton në udhezimet bazë të mëposhtme të cilat duhet të ndiqen me përpikmeri nga Kontraktori që do të ndermarrë kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dimërore.

- a. Debora duhet të pastrohet para se të forcohet ose të ngjeshet nga trafiku.
- b. Për të lehtësuar pastrimin duhet të shpërndahet kripe gjatë renies së borës (para pastrimit) në mënyrë që të shmangët ngjeshja e saj në një shtrese të fortë.
- c. Debora duhet të pastrohet për sa kohë që është e lagur dhe e pangjeshur. Kjo do të parandalojë krijimin e e një shtrese të fortë dhe të ngjeshur.
- d. Pastrimi i dëborës duhet të fillojë kur trashësia e saj është 3-5 cm. Rrugët me dy kalime duhet të pastrohen nga e djathta duke parë nga qendra e pjesës kaluese në drejtimin e udhëtimit. Me një fshirje në secilin drejtim përfitohet një gjëresi e pastruar prej 5.50 m.
- e. Here pas here automjetet duhet të ndalojnë për të lejuar kalimin e trafikut të grumbulluar pas tyre.
- f. Pastrimi i dëborës përfshin gjithashtu pastrimin e kanaleve anash rrugëve të fshatrave

### **4. Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punetoreve dhe personelit si me poshte:**

- Fikse zjarri të levizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 cope
- Komplet i ndihmes së shpejte minimumi 5 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në rrugë minimumi 5 cope

Specifika të tjera:

- a) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak.

- b)** Mjetet duhet te jene ne dispozicion cdo dite ,24 ore gjate kohes se vlefshmerise se kontrates per te siguruar kryerjen e sherbimeve te parashikuar ne preventive sipas nevojave dhe gjendjes se rrugeve .
- c)** Sherbimi I mirembajtjes se rugeve rurale do te monitorohet ne menyre te vazhdueshme nga Agjensia E Sherbimeve Publike ,Bashkia Devoll gjate gjithe periudhes se vlefshmerise se kontrates .Specifikat ne lidhje me dorezimin e situacioneve dhe pagesat do te percaktohen ne kontraten e lidhur me operatorin ekonomik fitues .